



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 966/ 2 prot.,

Datë 23.04.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizim i Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “KALIA” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-99189-03-25-2024, me objekt: “*Blerje Boje dhe materiale speciale për vijëzime rruge*”, me fond limit: 3.232.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz.

Ankimues: Operatori ekonomik “KALIA” SHPK me Nipt L41320036L me adresa: Rruga “Hoxha Tasim”, vila Kalia, Kati i dytë Paskuqan, Tirane.

Autoriteti Kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz
Adresa: *Bulevardi “Nënë Tereza”, Nr.492, Kamëz.*

Në datën 22.04.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dhe autoritetit kontraktor është protokolluar ankesa me numër elektronik A/2024/3993 datë 22.04.2024, dhe me nr. 966/2024 prot, datë 22.04.2024 e operatorit ekonomik “KALIA” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-99189-03-25-2024, me objekt: “*Blerje Boje dhe materiale speciale për vijëzime rruge*”, me fond limit: 3.232.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “KALIA” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimes “KALIA” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 966 prot, datë 22.04.2024.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Pika 2.3.3 Kapaciteti Teknik, Operatori ekonomik nuk ka paraqitur katalog ose skeda teknike për bojrat, fosforin dhe diluentin në gjuhën shqipe ose të përkthyer, e cila nuk plotëson kushtet sipas përcaktimeve në DST.

Pika 2.3.4 Operatori ekonomik ka paraqitur mostrat në vendin dhe orën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor por në kundërshtim me specifikimet e kërkuara në DST, pasi boja e zezë akrelike rezulton me datë skadence 02.2024, si dhe bojë bikomponente paste e kuqe rezulton me date skadence 09.03.2024, si dhe të gjitha bojërat e paraqitura pranë Autoritetit Kontraktor janë me date skadence brenda vitit 2024 e cila bie ndesh me kriteret e kërkuara në DST.

Pika 2.3.5 Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur deklarat garancie për mallin objekt prokurimi konform kriterit të përcaktuar në DST, për një periudhë jo më pak se një vit nga data e lëvrimin të mallit, si dhe shkronja c) e pikës 2.3.3 e cituar nga OE nuk ekziston. Ligji nr. 162 “Për Prokurimin Publik”, VKM, 285, date 19.05.2021, Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik. DST

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 23.04.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro